



Prishtine, data: 01.07.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 4811 dt. 26.12.2018 për mos pagesën e rentës ndaj: **“Dafa Horizont” Sh.A** me nr.të biznesit 70372324, me adresë; Magjistralja Ferizaj – Prishtinë , merr këtë:

A K T V E N D I M

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtresave për **“Dafa Horizont” Sh.A** me nr.të biznesit 70372324, me adresë; Magjistralja Ferizaj – Prishtinë, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

A r s y e t i m

Ndaj **“Dafa Horizont” Sh.A** me nr.të biznesit 70372324, me adresë; Magjistralja Ferizaj – Prishtinë, KPMM ka lëshuar aktin administrativ nr. 4811 dt. 26.12.2018.


Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.26.12.2018 dhe me dt.19.03.2021 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .


Ramiz Krasniqi

Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE (KPMM), në pajtim me nenin 48.50 si dhe nenit 33 paragrafi 4 pika a) të Rregullores së UNMIK-ut, 2005/3 mbi Minerat dhe Mineratet në Kosovë, nenit 50 paragrafi 6, nenit 53, nenit 34 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1.3 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, ndaj "Dafa Horizont" SH.A. me NRB 70372324 me adresë: Dardani, Ferizaj me pronarë Daut Sadriu, në lidhje me Licencën e Shfrytëzimit Nr.567/ICMM/06, në procedurë administrative me datë 28.12.2018, nxjerr këtë:

**AKTVENDIM PËR MOS PAGESË TË RENTË MINERARE
NJOFTIM PËR DËSHTIM**

DEPART. DËSHMË SERIËK	NR. DËSHMË NR. SERIË NR. FOLJË	48/1
NR. DËSHMË NR. SERIË NR. FOLJË	26.12.2018	

1. Ndaj: "Dafa Horizont" SH.A. me NRB 70372324 me adresë: Ferizaj, Magjistralja Ferizaj - Prishtinë.
2. "Dafa Horizont" SH.A. sipas Licencës së Shfrytëzimit Nr.567/ICMM/06 ka mbet pa kryer obligimet e tantimës për shumën 78,205.88 € (shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesë euro e tetëdhjetë e tetë cent) të rërës kuarcore.
3. Në pajtim me nenit 34 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1.3 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, ndërmarrja mbetet e detyruar që të dëshmojë dhe paguaj tantimën gjithsej në vlerë prej 78,205.88 € (shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesë euro e tetëdhjetë e tetë cent) në këtë xhirollogari 1000430070005950.
4. Pala ka 15 ditë afat nga data e plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përeaktuar në pikën 3 të dispozitivit

Arsyetim

Ndërmarrja "Dafa Horizont" SH.A. ka poseduar Licencë të Shfrytëzimit me Nr.567/ICMM/06 e cila ka skaduar me datë 03.12.2012, licenea në fjalë ju ka nënshtruar të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga neni 33 i Rregullores së UNMIK-ut, 2005/3 e ndryshuar me nenit 34 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

Bazuar në nenin 50 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale KPMM-ja është organ përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare. Duke u mbështetur në dispozitat materiale të Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale nenit 34 paragrafi 4 si dhe nenit 26 paragrafi 2 i Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale, ndërmarrja është e obliguar që në KPMM për çdo tremujor të sjell dëshmi me shkrim se renta minerare është raportuar dhe paguar në shumën dhe mënyrën e paraparë sipas pjesës IX të LMM-së.

Detajet e obligimeve të raportuara të pa paguara i keni si në vijim

Ndërmarrja	Afati pageses	Periudha	Viti	Deklaruar	Interesi	Bilanci
Dafa Horizont" SH.A	31.12.2007	4	2006	16,349.88	0.00	16,349.88
Dafa Horizont" SH.A	23.11.2012	4	2011	61,856.00	0.00	61,856.00
			Totali	78,205.88	0.00	78,205.88

Ndërmarrja "Dafa Horizont" SH.A, sipas Licencës të Shfrytëzimit me Nr.567/ICMM/06 e cila tani është e skaduar bazuar në të dhënat e mësipërme nuk iu është përmbajtur kushteve të licencës të parapara sipas Ligjit të Minerave.

Në rast se "Dafa Horizont" SH.A, sipas Licencës të Shfrytëzimit me Nr.567/ICMM/06 nuk i përmbushë detyrimet e saj brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, KPMM do të ndërmarr masa ligjore me qëllim të ekzekutimit të këtij vendimi në përputhje me Ligjin Nr.04/L-139 të Procedurës Përmbarimore.


Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky akt administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i KPMM-së.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit Shqyrtues për Ankesa të KPMM-së.

Aktvendimi i dërgohet:

- Arkivit të KPMM-së,
- Palës.



Ramiz Krasniqi
Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale